



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

PLANI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT – ZKA, PËRGJEGJËSIT, AKTIVITETET DHE DINAMIKA E ZBATIMIT

PRISHTINË: 23.06.2020

Hyrje

Me ligjin 05/L-055 " Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës". i është dhënë e drejta ekskluzive që të auditoi të gjitha subjektet e sektorit publik të cilat janë përfituese dhe shfrytëzuese të parasë publike nëpërmjet të buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Ky kontroll është definuar si kontroll i jashtëm, funksioni i të cilit është të auditoi këto subjekte nëse aktivitetet e këtyre subjekteve janë në pajtueshmëri me objektivat e përcaktuara nga vetë institucioni dhe me ligjet dhe rregulloret në fuqi duke verifikuar shkallen e zbatimit të objektivave të institucionit (matjen e performances), pajtueshmërisë me to dhe me ligjet në fuqi.

Në harmoni me këto të cilat u ceken më lartë, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, nëpërmjet Raportit të Auditimit nr. 783 të datës 09.06.2020 ka informuar kryetarin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP-it lidhur me përfundimin e aktivitetit auditues për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën 01 janar – 31 dhjetor 2019.

Në bazë të vlerësimeve të auditorit të përgjithshëm është dhënë edhe opinion i tij për pasqyrat financiare i cili është përkufizuar si në vijim:

Sipas opinionit tone pasqyrat financiare Vjetore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

FOKUSIMI I AUDITIMIT TË AUDITORIT TË ZKA

Aktivitetet e auditimit të auditorit të Përgjithshëm janë të fokusuar kryesisht në auditimin e :

- **Pasqyrave financiare vjetore që përfundojnë me 31.12.2019;**
- **Menaxhimi financiar dhe kontrolli;**
- **Zbatimi i Rekomandimeve.**

Në bazë të fokusimit të auditimit edhe rekomandimet janë dhënë në ato fusha. Këto rekomandime kanë të bëjnë me:

I. QEVERISJA,

II. MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI

Në fushën e Qeverisjes dhe të menaxhimit financiar dhe kontrollit rekomandimet e auditorit të Përgjithshëm janë :

PLANI ,DINAMIKA ,PËRGJEGJËSIT DHE AKTIVITETET E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRES KOMBËTARE AUDITIMIT

NR	PËRSHKRIMI I REKOMANDIMIT	PËRGJEGJËSIT E ZBATIMIT	AKTIVITETET QË DUHET NDËRMARRË	AFATI I IMPLEMENTIMIT
1	Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-së duhet të sigurojë se të gjitha pasurit janë të regjistruara në regjistra përkatës në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plot dhe i sakt.	ZKA dhe ZKF	Kryesuesi i PZAP-it këtë rekomandim e ka përmbushur	Mars 2020

Mulë Desku,
Kryesues i Sekretariatit të PZAP-së

